VENDIM
Nr. 123, datë 18.3.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 463, DATË 6.10.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR CAKTIMIN E TENDERIT SI FORMË TË PRIVATIZIMIT TË PAKETAVE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", dhe të pikave 1 dhe 2, të kapitullit I, të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohen nga shteti", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.463, datë 6.10.1999, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet:

"Kriteret bazë të vlerësimit të ofertave do të jenë sipas pikave të mëposhtme:

a) Çmim i ofruar	30
b) Investimi që do të kryhet	30
c) Plani i biznesit dhe cilësia teknike e propozimit	15
ç) Cilësia e investitorit	15

Kjo cilësi gjykohet sipas dokumentacionit të paraqitur në ofertë:

- Aktit të regjistrimit ose të ekuivalentit me të, të çertifikuar jo më pak se 30 ditë nga data e paraqitjes së tij.
- Bilancit kontabël, të audituar të paktën për tri vitet e fundit;
- Raportit të auditorëve të huaj për tri vitet e fundit;
- Përmbledhëses së veprimtarive kryesore (duke përcaktuar veprimtaritë) dhe përvojës në veprimtari të tilla në Europën Qendrore ose Lindore dhe në Shqipëri. Pjesëmarrja në privatizime, në këto vende:
- Të ketë reputacion dhe përvojë të drejtpërdrejtë në prodhimin përkatës, jo më pak se 5 vjet;

d) Tregues për punësimin dhe planet për ritrajnimet10.".

2. Pika 3 ndryshohet:

"Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhërin për fillimin e procedurës së privatizimit me tender të shoqërive.".

3. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Depozita e garancisë së tenderit do të jetë një vlerë fikse prej 30 000 (tridhjetë mijë) USD-sh.".

4. Pas pikës 3/1, shtohet pika 3/2, me këtë përmbajtje:

"3/2. Dokumentacioni do të jetë i disponueshëm për t'u bërë i njohur nga çdo i interesuar.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta